



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:251729

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06259778

PPP.nr.79/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditores së përmbarimit K, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit G.B.R nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 777.50 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike, lejuar me urdhrin për përmbarim, P.nr.1462/2022 të datës 28.10.2022, të përmbaruesit privat E.H nga Prizreni, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës më datën 07.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit G.B.R nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.1462/2022 të datës 28.10.2022, të përmbaruesit privat E.H nga Prizreni, për detyrimin në të holla në shumën prej 777.50 euro.

II. MBETET në fuqi i njëjti urdher për përmbarim, për detyrimin në të holla në shumën prej 777.50 euro.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

IV. Ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përmbarimore, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.

A r s y e t i m

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat E.H nga Prizreni, me urdhrin për përmbarim, P.nr.1462/2022 të datës 28.10.2022, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditores së

përmbaramit, K, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër debitorit të përmbaramit G.B.R nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për përmbaramin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 777.50 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me energji elektrike për periudhën kohore nga data 24.11.2021 deri më datën 08.10.2022.

Kundër këtij urdhri për përmbaram, pas pranimit të tij, debitori ka ushtruar prapësim, më gjerësisht si në arsyetimin e këtij prapësimi, ndërsa pas pranimit të prapësimit nga pala kreditore, ka parashtruar përgjigje në prapësim, më gjerësisht si në përgjigjen në prapësim.

Sa i përket dokumentit përmbaramor, gjykata erdhi në përfundim se kreditorja e përmbaramit, propozimin për përmbaram e ka bërë sipas dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 777.50 euro, në emër të shpenzimeve për furnizim me energji elektrike. Pra, dokumenti mbi të cilin pala kreditore e mbështet propozimin për përmbaram përbën dokument të besueshëm, në përputhje me nenin 29 par. 1 nën par. 2 të LPP-së, sipas të cilës dispozitë ligjore shprehimisht theksohet se *“Përmbarami me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*.

Në propozimin për përmbaram të datës 28.10.2022, të lejuar nga përmbaruesi privat E.Hnë Gjakovë me urdhrin P.nr.1462/23 të datës 28.10.202, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 24.11.2021 deri më datën 08.10.2022.

Gjykata nga kartela e konsumatori gjeti se debitori për periudhën nga data 24.11.2021 deri më datën 08.10.2022 ka krijuar borxh në vlerën prej 777.50 euro, andaj vendosi ta lërë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat.

Pretendimet e debitorit se borxhi i kërkuar nga ana e kreditorit është parashkruar gjykata i vlerëson si të pabazuara. Në nenin 360 par.1 të LMD-së parashihet që *“1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa në nenin 360 par.2 të LMD-së, përcaktohet: *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*. Sipas propozimit për përmbaram kreditorja ka kërkuar borxhin për periudhën kohore nga data 24.11.2021 deri më datën 08.10.2022, ndërsa propozimin për përmbaram kreditorja e ka parashtruar më datë 28.10.2022. Andaj kjo gjykatë vendosi ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe ta lërë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat P.nr.1462/2022 të datës 28.10.2022 sepse nuk ka kaluar afati caktuar me ligj në kohëzgjatje prej një (1) viti, ashtu që nuk arritur parashkrimi i borxhit për këtë periudhë kohore siç pretendon debitori.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Gjykata mund*

të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”.

Prandaj nga ajo që u theksua më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 3, 5, 21, 29, 37, 40, 69, 71, 73, 77 dhe nenit 78 të LPP-së lidhur me nenin 9 dhe 12 të Ligjit nr. 05/L-118 të datës 18.04.2018 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr.04/L-139 të datës 20.12.2012 të LPP-së si dhe lidhur me nenin 65 dhe 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 04/L-077.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.79/2022 më datë 07.10.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.